



**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I BUXHETIT DHE FINANCËS**

Nr. 2655 prot.

Tiranë, më 25.09.2025

Lënda: Dërgohet raporti dhe anekset e monitorimit të buxhetit për 8 mujin 2025.

**MINISTRISË SË FINANCEVE
Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit**

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr.3, Tiranë

Në zbatim të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave nr.2, dt.24.01.2025, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, ju dërgojmë bashkëlidhur raportin dhe anekset e monitorimit të buxhetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për periudhën janar – gusht 2025, plotësuar sipas kërkesave të Udhëzimit nr.14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Dëshira Pasko





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

RAPORTI

**I MONITORIMIT TË BUXHETIT TË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË
LARTË TË DREJTËSISË PËR 8 MUJORIN E VITIT 2025**

Përmbajtja:

- Hyrje
- Relacion shoqërues
- Aneksi nr.1 “Raporti përmbledhës i shpenzimeve të Ministrisë/ institucionit buxhetor”
- Aneksi nr.1.1 “Raporti i shpenzimeve të ministrisë/ institucionit buxhetor sipas kapitujve”
- Aneksi nr.1.2 “Shpenzimet buxhetore në total programi dhe total ministrie/ institucioni buxhetor sipas artikujve”
- Aneksi nr.2 “Raporti mbi ekzekutimin e buxhetit në nivelin e programit të buxhetit”
- Aneksi nr.2.1 “Shpenzimet e programit sipas kapitujve”

- Aneksi nr.3 “Raporti i performancës së produkteve të programit”
- Aneksi nr.3.1 “Raporti i performancës së produkteve të programit sipas artikujve”
- Aneksi nr.3.2 “Devijacioni i kostos për njësi në vite”
- Aneksi nr.4 “Raporti i realizimit të treguesve të performancës së programit”

HYRJE

Me buxhetin në dispozicion për vitin 2025, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vijon ushtrimin e veprimtarisë në zbatim të detyrimeve që lindin nga Ligji 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, për realizimin e qëllimit të politikës së programit “*Garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi*”, duke pasur si synim kryesor arritjen e 2 objektivave kryesorë të këtij programi, që janë:

1. Fuqizimi i veprimtarisë për matjen e performancës së subjekteve të hetimit disiplinor mbi cilësinë dhe efikasitetin e dhënies së drejtësisë sipas standardeve evropiane
2. Rritja dhe zhvillimi i kapaciteteve menaxhuese, si dhe ngritja e nivelit të profesionalizmit nëpërmjet programeve trajnuese dhe zhvilluese në respekt të parimit të barazisë gjinore,

përmes realizimit të treguesve kyç të performancës dhe të produkteve të planifikuara për këtë vit.

Monitorimi i buxhetit për periudhën raportuese është kryer përmes vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore, si dhe krahasimit të nivelit faktik të treguesve të performancës me ato të planifikuara. Ky proces ndiqet në vijimësi nga strukturat përgjegjëse, të cilat kanë kryer monitorimin e treguesve buxhetorë në funksion të realizimit të objektivave dhe masave të planit strategjik dhe planit të veprimit të ILD-së për vitet 2023-2025.

Ky raport monitorimi pasqyron realizimin e fondeve buxhetore të ILD-së, të detajuara në nivel kategorie të shpenzimeve buxhetore, kundrejt treguesve të planifikuara, duke mundësuar në këtë mënyrë sigurimin e një informacioni orientues në drejtim të përmirësimit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit.

RELACION

PROGRAMI BUXHETOR “VEPRIMTARIA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË” - KODI “03320”

Me ligjin nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, për veprimtarinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, u miratua buxheti fillestar prej 354,600 mijë lekë, i detajuar në :

1. Shpenzime korrente në shumën 302,900 mijë lekë
2. Shpenzime kapitale në shumën 51,700 mijë lekë

Gjatë periudhës së 8 mujorit, buxheti i ILD-së ka pësuar ndryshime me një reduktim në vlerën 29,700 mijë lekë. Me shkresën nr.6368/1, datë 17.04.2025 të Ministrisë së Financave është miratuar detajimi i fondit të veçantë për vitin 2025, me një shtesë prej 300 mijë lekë në artikullin 606. Me Aktin Normativ nr.6, datë 11.06.2025, në grupin e shpenzimeve korrente buxheti është pakësuar në vlerën 30,000 mijë lekë, nga të cilat 27,500 mijë lekë në zërin “Paga” si dhe 2,500 mijë lekë në zërin “Kontribute për sigurime shoqërore e shëndetësore”, nga fondet e papërdorur si rezultat i problematikës vijuese lidhur me vendet e paplotësuara në pozicionet “Inspektor magjistrat” dhe “Inspektor jo magjistrat”.

Në mbyllje të periudhës raportuese, buxheti i rishikuar i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është në total 324,900 mijë lekë, nga i cili:

1. Për Shpenzime korrente 273,200 mijë lekë
2. Për Shpenzime kapitale 51,700 mijë lekë

Në zbatim të rekomandimit nr.2.1 të Raportit përfundimtar të Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit të ushtruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për periudhën 01.01.2021-31.12.2023, nga ana e strukturave përgjegjëse të ngarkuara për ndjekjen e zbatimit të buxhetit, janë marrë masat e nevojshme për mirëmenaxhimin dhe përdorimin me efektivitet të lartë të fondeve të miratuara në ligj, me qëllim uljen e numrit të kërkesave për rialokim fondesh. Gjatë kësaj periudhe, në buxhetin e vitit 2025 është evidentuar 1 rast rialokimi në fondet buxhetore për shpenzimet kapitale. Ky rialokim është kërkuar për shkak të pezullimit të procedurës së prokurimit me objekt “Ndërtimi i dhomës së serverave” nga Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr.967/6 prot. të korigjuar, me të cilin është kërkuar rishikimi i projektit. Ministria e Financave, me shkresën nr.10133/1 prot., datë 08.07.2025 miratoi kërkesën e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për sigurimin e fondit për hartimin e projektit të dhomës së serverave, art. 230, kodi 18AB203, nëpërmjet transferimit nga fondi për “Blerje pajisje informatike”, art. 231, kodi M630013, në vlerën 602 mijë lekë .

Në ligj është miratuar, gjithashtu, numri prej 101 punonjës, në përputhje me numrin total të strukturës dhe organikës së miratuar për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me vendimin nr. 28/2020, të ndryshuar, të Kuvendit.

Në mbyllje të 8 mujorit 2025, organika e institucionit është plotësuar me 84 punonjës, duke rezultuar me 17 vende të lira, nga të cilat: 1 vend në pozicionin “Këshilltar”, 6 vende në pozicionin “Inspektor magjistrat”, 5 vende për pozicionin “Inspektor jo magjistrat”, 1 vend në pozicionin “Ndhmës inspektor” dhe 4 vende në administratë.

Mosplotësimi i vendeve vakante, veçanërisht për pozicionet “Inspektor magjistrat” dhe “Inspektor jo magjistrat”, ka sjellë vështirësi për stafin aktual në përballimin e volumit të punës. Megjithatë, edhe pse në situatë mbingarkese, njësitë e inspektorëve dhe ndihmës inspektorëve janë angazhuar maksimalisht në ruajtjen e performancës së institucionit përsa i përket trajtimit brenda afatit të kërkesave dhe ankesave të ardhura, si dhe në realizimin e inspektimeve tematike dhe atyre institucionale.

Gjithashtu, me VKM nr. 19, datë 09.01.2025, për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë u miratuan 12 punonjës me kontratë të përkohshme për vitin 2025; numri faktik në mbyllje të periudhës është 8 punonjës.

Në tabelën e mëposhtme jepet informacioni mbi planifikimin fillestar, ndryshimet në buxhetin e ILD-së, shpenzimet faktike dhe realizimin në % ndaj planit, sipas zërave të shpenzimeve.

Art.	Emërtimi	Ligji buxheti 2025 (000 lekë)	Fondi i veçantë 2025 (000 lekë)	Transferi me buxheti 2025 (000 lekë)	Buxheti i rishikuar 2025 (000 lekë)	Shpenzime faktike 8 - 2025 (000 lekë)	Realizimi në %
600	Paga	235,300		-	207,800	112,899	54.33%
601	Sigurime	31,400		-	28,900	15,983	55.31%
602	Mallra shërbime	34,370		-	34,370	19,803	57.62%
605	Transferta org.ndërk.	600		-	600	0	0
606	Transf.për individ.	1,230	300	-	1,530	192	12.57%

230	Kapitale të patrupëzuara	1,200		(+) 602	- 1,802	475	26.37%
231	Kapitale të trupëzuara	50,500		(-) 602	49,898	691	1.39%
	TOTALI	354,600	300	-	324,900	150,043	46.18%

Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, niveli i shpenzimeve faktike është si më poshtë:

Art.	Emërtimi	Shpenzime faktike 8- 2024 (000 lekë)	Shpenzime faktike 8 - 2025 (000 lekë)	Ndryshimi në vlerë (000 lekë)	Ndryshimi në %
600	Paga	111,643	112,899	(+) 1,256	+1.12%
601	Sigurime	15,832	15,983	(+) 151	+0.9%
602	Mallra shërbime	19,940	19,803	(-) 137	-0.68%
605	Transferta org.ndërk.	-	-	-	-
606	Transf.për individ.	123	192	(+) 69	+56%
230	Kapitale të patrupëzuara	-	475	(+) 475	+100%
231	Kapitale të trupëzuara	58,535	691	(-) 57,844	-98.8%
	TOTALI	206,073	150,043	(-) 56,030	-27.18%

Në nivelin krahasimor të shpenzimeve faktike, impaktin më të lartë e kanë shpenzimet kapitale; kjo, pasi, gjatë vitit 2024, janë kryer pagesat e punimeve të rikonstruksionit të godinës së institucionit të ILD.

Sa i përket performancës së buxhetit për 8 mujorin sipas klasifikimit ekonomik të shpenzimeve korrente dhe projekteve të investimeve, më analitikiht kemi:

Zërat 600-601 janë me një realizim prej 128,882 mijë lekë, ose në masën 87.20% të planit të 8 mujorit, ku përfshihen shpenzimet për paga e sigurime për punonjësit e organikës, si dhe për punonjësit me kontratë të përkohshme.

Zërat 602-606 me një realizim faktik prej 19,995 mijë lekë ose në masën 85.8 % të planit të 8 mujorit. Nga këto:

Shpenzimet operative – zëri 602 (të rakorduara me pagesat në sistemin e thesarit), janë në vlerën 19,803 mijë lekë, ku përfshihen pagesat e faturave mujore të energjisë elektrike, ujit, postës, telefonisë, me një total prej 1,967 mijë lekë, shpenzimet për riabonimin vjetor të licensave të sistemit SMAD në vlerën 5,089 mijë lekë, shpenzimet për ruajtjen dhe sigurinë e godinës 3,677 mijë lekë, për blerje karburanti 1,170 mijë lekë, shpenzime të siguracionit dhe mirëmbajtjes së automjeteve 989 mijë lekë, shpenzimet për udhëtimet brenda e jashtë vendit 2,148 mijë lekë, shpenzimet për blerjen e materialeve të logjistikës për stafin si dhe për mbarëvajtjen e veprimtarisë së institucionit, si materiale kancelarie, materiale pastrimi e materiale të tjera zyre 1,328 mijë lekë, pagesat për shërbim interneti, paketë sigurie dhe hostim i faqes Web, abonim në programin financiar në cloud, e shërbime të tjera nga të tretët në shumën 1,620 mijë lekë, sigurim jete dhe shëndeti në shumën 590 mijë lekë, pagesa për honorare 50 mijë lekë, etj.

Ecuria e realizimit të fondeve për shpenzimet operative që lidhen me faturat mujore është në nivelin e parashikimeve sipas zërave përkatës. Ndërkohë, po ndiqet me korrektësi realizimi i procedurave të prokurimit sipas parashikimeve në Regjistrin e prokurimeve publike për vitin 2025.

Në zërin 605 është parashikuar fondi për pagesën e kuotës vjetore për RESIJ (Rrjeti European i Shërbimeve të Inspektimit), ku ILD është anëtar që prej qershorit të vitit 2023. Jemi në pritje të njoftimit zyrtar/ dokument financiar për pagesën e detyrimit.

Në vlerën 192 mijë lekë janë shpenzimet në zërin 606, ku përfshihet pagesa për 1 rast ndihmë e menjëhershme nga fondi i veçantë në shumën 30 mijë lekë dhe pagesat për mbulimin e kufirit të shpenzimeve të telefonisë celulare për kategoritë e funksionarëve të parashikuar në VKM nr.673, datë 02.09.2020, të ndryshuar , në shumën 162 mijë lekë.

Projektet e investimeve

Realizimi i projekteve të investimeve për 8 mujorin 2025, është si në tabelën e mëposhtme:

Kodi i projektit	Emërtimi i projektit	Plan buxheti 2025 (000 lekë)	Shpenzime faktike 8 2025 (000 lekë)	Diferenca 8 mujori 2025 (000 lekë)	Realizimi në %
M630001	Pajisje zyre	25,000	186	24,814	0.74%
18AB203	Ndërtimi i dhomës së serverave	18,200	-	18,200	0%
18AB204	Sistemi i videokonferenc. në sallën e mbledhjeve	5,200	-	5,200	0%
25AC801	Hartim projekti per ndërtimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve dhe dokumenteve	1,200	-	1,200	0%
M630013	Pajisje informatike	1,498	505	993	33.71%
18AB203	Hartim projekti per ndërtimin e dhomës së serverave	602	475	127	78.9%
	TOTALI	51,700	1,166	50,534	2.26.%

Përsa i përket statusit të deritanishëm të procedurave të prokurimit për realizimin e projekteve të investimeve, në këtë fazë të përgatitjes së këtij informacioni raportohet se:

1. “Blerje mobilje për zyrat e ILD” kodit M630001 - Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (AK) ka shpallur procedurën e prokurimit me një fond limit prej 20,575,680 lekë (pa TVSH), në datën 18.07.2025, nëpërmjet faqes zyrtare të Agjencisë së Prokurimeve Publike. Procedura është publikuar në portalin e APP në datën 21.07.2025, me nr. REF-55352-07-18-2025, parashikuar për t’u zhvilluar me 11.08.2025. Në zbatim të parashikimeve të legjislacionit në fushën e prokurimeve publike, është ushtruar e drejta e ankimit për dokumentat e tenderit nga një operator ekonomik. Procedura e prokurimit është pezulluar dhe është caktuar një zyrtar i vetëm për shqyrtimin e ankesës, në përputhje të plotë me parashikimet e pikës 1 të nenit 101 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik, ka marrë vendimin KPP 1012/2025, datë 06.08.2025. AK është njohur me vendimin KPP 1012/2025, datë 06.08.2025, dhe me qëllim zbatimin e tij dhe të vendimit KSHA nr. 334/31, datë 04.08.2025, ka hartuar dhe publikuar në SPE në datën 11.08.2025, Shtojcën “Njoftim për ndryshimin e dokumentave të tenderit” si dhe njësia e prokurimit ka përcaktuar afatin e ri të hapjes së ofertave për në datën 20.08.2025. Pas vlerësimit të ofertave të paraqitura, në datën 02.09.2025, është publikuar Njoftimi Paraprak i Fituesit në SPE, datë, nga e cila kanë filluar dhe afatet e ankimit për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi. Referuar parashikimeve të legjislacionit në fushën e prokurimeve publike, është ushtruar e drejta e ankimit për kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertave nga dy operatorë ekonomikë. Më datë 16.09.2025 janë trajtuar ankesat nga zyrtari i caktuar për shqyrtimin e ankesës në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (AK), vendime, të cilat u janë komunikuar Titullarit të AK, Ankuesit dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Procedura e prokurimit aktualisht është e pezulluar deri në marrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik, në zbatim të parashikimeve të legjislacionit në fushën e prokurimeve publike.
2. “Ndërtimi i dhomës së serverave” kodit 18AB203 - AK ka shpallur procedurën e prokurimit objekt ankimi në datën 30.07.2025, nëpërmjet faqes zyrtare të Agjencisë së Prokurimeve Publike, procedura është publikuar në portalin e APP në datën 31.07.2025 me nr. REF-56666-07-30-2025 parashikuar për tu zhvilluar me 15.08.2025. Në zbatim të parashikimeve të legjislacionit në fushën e prokurimeve publike, më datë 06.08.2025 është ushtruar e drejta e ankimit për dokumentat e tenderit nga një operator ekonomik. Procedura e prokurimit është pezulluar dhe është caktuar një zyrtar i vetëm për shqyrtimin e ankesës, në përputhje të plotë me parashikimet e pikës 1 të nenit 101 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Në datën 11.08.2025 është trajtuar ankesat nga zyrtari i caktuar për shqyrtimin e ankesës në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (AK), vendim, i cili u është komunikuar Titullarit të AK,

Ankuesit dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Procedura e prokurimit aktualisht është në fazën e zbatimit të vendimit nr.1238/2025 të Komisionit të Prokurimit Publik, sipas parashikimeve të legjislacionit në fushën e prokurimeve publike.

3. “Sistemi i videokonferencave në sallën e mbledhjeve” kodit 18AB204 - Për këtë procedurë prokurimi është hartuar kërkesa nga Sektori i Teknologjisë së Informacionit më datë 29.07.2025, është miratuar relacioni mbi hartimin e specifikimeve teknike dhe për përlogaritjen e fondit limit. Me urdhrin nr. 87, datë 10.09.2025, është ngritur njësi e prokurimit, anëtarët e të cilës po punojnë për hartimin dhe përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme, që u bashkëlidhen atyre.
4. “Hartimi i projektit për ndërtimin e Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve dhe Dokumenteve në Zyrën e ILD-së” kodit 25AC801 - Për këtë procedurë prokurimi, më datë 11.09.2025, është hartuar kërkesa nga Sektori i Teknologjisë së Informacionit. Komisioni i ngritur me udhrin nr. 93, datë 12.09.2025 aktualisht është në fazën e hartimit të specifikimeve teknike të detyrës së projektimit, termave të referencës dhe përlogaritjes së fondit limit për këtë procedurë prokurimi .

Referuar treguesve buxhetorë për 8 mujorin, si dhe mbështetur në kuadrin ligjor për prokurimet publike, parashikimi i realizimit të fondeve buxhetore të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në mbyllje të vitit 2025 është si më poshtë:

Art.	Emërtimi	Kodi i produktit	Plani 8 mujor (000/lekë)	Fakti 8 mujor (000/lekë)	Realizimi në %	Plani vjetor (000/lekë)	Realizimi i pritshëm vjetor (000/lekë)	Realizimi i pritshëm në %
600	Paga	96301AA	128,533	112,899	87.8	207,800	185,981	89.5
601	Sigurime	96301AA	19,267	15,983	82.9	28,900	24,276	84.0
602	Shpenzime operative	96301AA	21,670	19,803	91.3	34,370	33,800	98.3
605	Transferta për org.ndërkomb.	96301AA	600	0	0	600	600	100.0

606	Transferta për individët	96301AA	1,030	192	15	1,530	800	52
230	Hartim projekti per ndërtimin e dhomës së serverave	18AB203	602	475	78.9	602	475	78
230	Hartim projekti per ndërtimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve dhe dokumenteve	25AC801	1,200	0	0	1,200	1,200	10
231	Pajisje zyre	M630001	25,000	186	0.7	25,000	25,000	10
231	Pajisje informatike	M630013	1,498	505	33.7	1,498	1,200	80
231	Ndërtimi i dhomës së serverave	18AB203	18,200	0	0	18,200	15,967	87
231	Sistemi i videokonferencave në sallwn e mbledhjeve	18AB204	5,200	0	0	5,200	5,200	10
	TOTALI		222,800	150,043	67.3	324,900	294,499	90

Treguesit kyç të performancës dhe produktet:

❖ Treguesit kyç të performancës

Në nivel qëllimi të politikës së programit janë parashikuar 2 tregues performance, e konkretisht:

- ✓ Përgatitja e kuadrit rregullator për vlerësim dhe monitorim në funksion të krijimit të një sistemi të plotë dhe afatgjatë të përgjegjësisë dhe llogaridhënies së sistemit të drejtësisë.
- ✓ Rritja e transparencës nëpërmjet komunikimit dhe bashkëpunimit me publikun.

Në nivel objektiv, për vitin 2025 kemi këta tregues kyç të performancës:

Për objektivin nr.1 “*Fuqizimi i veprimtarisë për matjen e performancës së subjekteve të hetimit disiplinor mbi cilësinë dhe efikasitetin e dhënies së drejtësisë sipas standardeve evropiane*”

- ✓ Rritja e standardeve me qëllim zhvillimin e procesit të hetimit disiplinor në përputhje me parimet e ligjshmërisë e të procesit të rregullt ligjor sipas standardeve ndërkombëtare, përmes ndjekjes së aktiviteteve trajnuese, pjesëmarrjes aktive në forume profesionale dhe zhvillimin e vizitave studimore në inspektoratet homologe evropiane
- ✓ Shqyrtimi me profesionalizëm dhe efektivitet i ankesave të paraqitura
- ✓ Kryerja e inspektimeve sipas planit vjetor

Për objektivin nr. 2 “*Rritja dhe zhvillimi i kapaciteteve menaxhuese, si dhe ngritja e nivelit të profesionalizmit nëpërmjet programeve trajnuese dhe zhvilluese në respekt të parimit të barazisë gjinore*”, janë parashikuar këto tregues performance:

- ✓ % e grave në poste drejtuese ndaj totalit të posteve drejtuese të shërbimit civil në institucion me vlerë të synuar në masën 64%. Në mbyllje të 4 mujorit, ky tregues është realizuar në masën 62%.
- ✓ Numri i rasteve të diskriminimit me bazë gjinore, ndaj totalit të çështjeve të trajtuara në institucion duke synuar që, për vitin 2025, të mos ketë asnjë rast diskriminimi me bazë gjinore.
- ✓ Numri i grave të trajnuara me një parashikim vjetor 35 punonjëse të trajnuara.

❖ Produktet:

Për programin buxhetor “ Veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, është parashikuar produkti “***Inspektime të kryera dhe ankesa të trajtuara***”, kodi 96301AA.

Inspektimet tematike dhe institucionale

Inspektori i Lartë të Drejtësisë, me vendimin nr. 5, datë 31.01.2025 ka miratuar planin e inspektimeve për vitin 2025, ku janë miratuar 8 inspektime, nga të cilat 7 inspektime tematike dhe 1 inspektim institucional.

Gjatë 8 mujorit të vitit 2025 (janar-gusht), me miratimin e vendimeve ka filluar puna për kryerjen e inspektimeve. Ka përfunduar inspektimi i miratuar me vendimin nr. 8, datë 28.02.2025 “Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt: “Dokumentimi nga gjyqtarët i informimit të palëve rreth mundësisë për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim për çështjet civile të përfunduara për periudhën 01.05.2024 – 31.07.2024, pranë Gjykatave së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Tiranë, dhe Vlorë” dhe është hartuar raporti i inspektimi nr. 627/14 prot., datë 08.05.2025, afati për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të rekomandimeve është 15.05.2025-15.12.2025.

Gjithashtu, gjatë vitit 2025 ka vijuar ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të raporteve të inspektimeve të cilat janë përfunduar në vitin 2024:

- Raport inspektimi nr. 1326/81 prot., datë 20.12.2024, afati për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve është caktuar periudha 15.02.2025-15.07.2025;
- Raport inspektimi nr. 1348/46 prot., datë 30.12.2024, afati për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve është caktuar periudha 15.03.2025-15.09.2025.

Sa i përket inspektimeve të tjera ato janë parashikuar të përfundojnë brenda vitit 2025.

Ankesa të trajtuara

Për periudhën raportuese në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë trajtuar në total 985 ankesa, nga të cilat:

686 ankesa të trajtuara me vendim arkivimi pas shqyrtimit fillestar.

268 ankesa të trajtuara me vendim arkivimi pas verifikimit.

31 ankesa të trajtuara me vendim fillim hetimi disiplinor dhe në përfundim të hetimit, për 7 raste ILD ka paraqitur pranë këshillave përkatës kërkesat për procedim disiplinor.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Dëshira Pasko



ANEKSI 1.1 Raporti i Shpenzimeve të Ministrisë/Institucionit sipas kapitujve

Periudha e Raportimi 8-2025

Kodi i Ministrisë	Kodi i Kapitullit	Emërtimi i Kapitullit	Periudha raportuese	Buxheti	Artikujt buxhetore										Total
					230	231	600	601	602	603	604	605	606	Total	
			Shpenzime Kapitale të Patrupezuara	Shpenzime Kapitale të Trupezuara	Pagat	Kontitib e Sigurimeve Shoqërore	Mallra dhe Sherbime	Subveçnet	Të tjera Transfer. Korrente Brendshme	Transfer. Korrente Huese	Transferita për Buxhetet Familjare dhe Individet				
63	01	Nga Buxheti	2025	Plani fillestar	51,700,000.00	235,300,000.00	31,400,000.00	34,370,000.00	0	0	600,000.00	1,230,000.00	354,600,000.00		
63	01	Nga Buxheti	2025	Plani i rishikuar	49,898,000.00	207,800,000.00	28,900,000.00	34,370,000.00	0	0	600,000.00	1,530,000.00	324,900,000.00		
63	01	Nga Buxheti	2025	Fakti	691,240.00	112,899,011.00	15,983,336.00	19,802,804.00	0	0	-	192,270.00	150,043,867.00		
63	01	Nga Buxheti	2025	Angazhime	-	-	-	2,461,032.00	0	0	-	-	2,461,032.00		
63		Total	2025	Plani fillestar	51,700,000.00	235,300,000.00	31,400,000.00	34,370,000.00	0	0	600,000.00	1,230,000.00	354,600,000.00		
63		Total	2025	Plani i rishikuar	49,898,000.00	207,800,000.00	28,900,000.00	34,370,000.00	0	0	600,000.00	1,530,000.00	324,900,000.00		
63		Total	2025	Fakti	691,240.00	112,899,011.00	15,983,336.00	19,802,804.00	0	0	-	192,270.00	150,043,867.00		
63		Total	2025	Angazhime	-	-	-	2,461,032.00	0	0	-	-	2,461,032.00		
63		Ndryshimi ne vlere absolute	2025		(1,802,000.00)	(27,500,000.00)	(2,500,000.00)	-	-	-	300,000.00	(29,700,000.00)			
63		Realizimi ne %	2025		1.39%	54.33%	55.31%	57.62%	0.00%	0.00%	0.00%	12.57%	46.18%		

Emri	ARBER PRENGA	Emri	DESHIRI PASKO
Firma		Firma	
Data	24.09.2025	Data	26.09.2025
Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit		Sekretari i Pergjithshëm	




Aneksi 1.2 "Shpenzimet Buxhetore në Total Programi dhe Total Ministrië/Institucioni Buxhetor"

Periudha e Raportimit 8-2025

Kodi i Ministriës	Kodi i Programi	Emërtimi i Programit	Viti	Tipi i Buxhetit	Art. 230	Art. 231	Art. 600	Art. 601	Art. 602	Art. 605	Art. 606	Total
63	03320	Veprimtaria e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	2025	Plani fillestar	-	51,700,000.00	235,300,000.00	31,400,000.00	34,370,000.00	600,000.00	1,230,000.00	354,600,000.00
63	03320	Veprimtaria e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	2025	Plani i rishikuar	1,802,000.00	49,898,000.00	207,800,000.00	28,900,000.00	34,370,000.00	600,000.00	1,530,000.00	324,900,000.00
63	03320	Veprimtaria e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	2025	Shpenzime faktike	475,206.00	691,240.00	112,899,011.00	15,983,336.00	19,802,804.00	-	192,270.00	150,043,867.00
63	03320	Veprimtaria e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	2025	Angazhime	-	-	-	-	2,461,032.00	-	-	2,461,032.00
63		Ndryshimi në vlerë absolute	2025		1,802,000.00	(1,802,000.00)	(27,500,000.00)	(2,500,000.00)	-	-	300,000.00	(29,700,000.00)
63		Realizimi në %	2025		26.37%	1.39%	54.33%	55.31%	57.62%	0.00%	12.57%	46.18%
63		Total i Ministrië/Institucionit	2025	Plani fillestar	-	51,700,000.00	235,300,000.00	31,400,000.00	34,370,000.00	600,000.00	1,230,000.00	354,600,000.00
63		Total i Ministrië/Institucionit	2025	Plani i rishikuar	1,802,000.00	49,898,000.00	207,800,000.00	28,900,000.00	34,370,000.00	600,000.00	1,530,000.00	324,900,000.00
63		Total i Ministrië/Institucionit	2025	Shpenzime faktike	475,206.00	691,240.00	112,899,011.00	15,983,336.00	19,802,804.00	-	192,270.00	150,043,867.00
63		Total i Ministrië/Institucionit	2025	Angazhime	-	-	-	-	2,461,032.00	-	-	2,461,032.00
63		Numri i punonjësve në Total	2025	Plani fillestar								101
63		Numri i punonjësve në Total	2025	Plani i rishikuar								101
63		Numri i punonjësve në Total	2025	Numri faktik								84

Emri	Emri
Emri	Emri
Firma	Firma
Data	Data



ARBER PRENGA
24.09.2025

Drejtesi i Ekipit Menaxhues të Programit

Emri i Grupit: Veprimtaria e Rivlerësimit në sistemin e Drejtësisë Kodi i grupit: 63												
Emri i programit: Veprimtaria e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë Kodi i programit: 03320												
Shpenzimet e Programit												
Kodi i produktit	Emërtimi	Viti paraardhës 2024			Periudha raportuese			Periudha raportuese			Ndryshimi Vjetor (Plan - Fakt)	% e realizimit
		Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Fillestar Vjetor Viti 2025	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2025	Struktura e shpenzimeve në %	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progressive	Struktura e shpenzimeve në %	(9)		
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7 (5-3))	(8)	(9)	10 (5-8)	11 (8/5)
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik												
Emërtimi												
600	Paga	188,274,989.00	75.24%	235,300,000.00	77.68%	207,800,000.00	76.06%	(27,500,000.00)	112,899,011.00	75.83%	94,900,989.00	54.33%
601	Sigurime Shoqërore	23,877,535.00	10.68%	31,400,000.00	10.37%	28,900,000.00	10.58%	(2,500,000.00)	15,983,336.00	10.74%	12,916,664.00	55.31%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	31,059,653.51	13.89%	34,370,000.00	11.35%	34,370,000.00	12.58%	-	19,802,804.00	13.30%	14,567,196.00	57.62%
603	Subvencione	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00%	-	0.00	0.00%	-	-
604	Transferita Korente të Brendshme	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00%	-	0.00	0.00%	-	-
605	Transferita Korente të Huaja	0.00	0.00%	600,000.00	0.20%	600,000.00	0.22%	-	0.00	0.00%	600,000.00	0.00%
606	Trans per Buxh. Fam. Individ	443,175.00	0.20%	1,230,000.00	0.41%	1,530,000.00	0.56%	300,000.00	192,270.00	0.13%	1,337,730.00	12.57%
	Nëntotali Shpenzime Korente	223,655,352.51	100.00%	302,900,000.00	100.00%	273,200,000.00	100.00%	-29,700,000.00	148,877,421.00	100.00%	124,322,579.00	54.49%
230	Kapitale të Trupëzuara	0.00	0.00%	0.00	0.00%	1,802,000.00	3.49%	1,802,000.00	475,206.00	0.00%	1,326,794.00	0.00%
231	Kapitale të Trupëzuara	138,204,038.99	100.00%	51,700,000.00	100.00%	49,898,000.00	96.51%	-	691,240.00	0.00%	49,206,760.00	1.39%
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendë	138,204,038.99	100.00%	51,700,000.00	100.00%	51,700,000.00	100.00%	1,802,000.00	1,166,446.00	0.00%	50,533,554.00	2.26%
230	Kapitale të Trupëzuara	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0	0.00	0.00%	-	0.00%
231	Kapitale të Trupëzuara	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0	0.00	0.00%	-	0.00%
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00	0.00%	0.00	0.00%
	Totali i Shpenzimeve Kapitale	138,204,038.99	100.00%	51,700,000.00	100.00%	51,700,000.00	100.00%	1,802,000.00	1,166,446.00	0.00%	50,533,554.00	2.26%
	Totali i Shpenzimeve Buxhetore të Programit	361,859,391.50	100.00%	354,600,000.00	100.00%	324,900,000.00	100.00%	(29,700,000.00)	150,043,867.00	100.00%	174,856,133.00	46.18%
	Shpenzime Korente nga të Ardhurat Jashtë limitit (K)	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00	0.00%	0	0
	Shpenzime Kapitale nga të Ardhurat Jashtë limitit (K)	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00	0.00%	0	0
	Totali i Shpenzimeve të Programit	361,859,391.50	100.00%	354,600,000.00	100.00%	324,900,000.00	100.00%	-29,700,000.00	150,043,867.00	100.00%	174,856,133.00	46.18%
Shpenzimet sipas produkteve të programit buxhetor												
Emërtimi												
Artikulli												
	Totali i Shpenzimeve Korente	223,655,352.51	61.81%	302,900,000.00	85.42%	273,200,000.00	84.09%	-29,700,000.00	148,877,421.00	99.22%	124,322,579.00	54.49%
Kodi i produktit	Emërtimi											
96301AA	Inspektime të kryera / Ankesa të trajtuara	223,655,352.51	100.00%	302,900,000.00	100.00%	273,200,000.00	100.00%	(29,700,000.00)	148,877,421.00	100.00%	124,322,579.00	54.49%
	Totali Shpenzime për Investime	138,204,038.99	38.19%	51,700,000.00	14.59%	51,700,000.00	15.91%	0.00	1,166,446.00	0.78%	50,533,554.00	2.26%
Kodi i produktit	Emërtimi											
18AB202	Blerje Licensash	0.00	0.00%	-	0.00%	-	0.00%	0	0.00	0.00%	-	0.00%
M630020	Blerje automjetelesh	6,492,000.00	0.00%	-	0.00%	-	0.00%	-	0.00	0.00%	-	0.00%

M630001	Blerje pajisje	1,999,180.00	1.45%	25,000,000.00	48.36%	25,000,000.00	48.36%	0	186,040.00	15.95%	24,813,960.00	0.00%
25AC801	Hartim projekti per ndertimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve dhe dokumenteve	0.00	0.00%	1,200,000.00	0.00%	1,200,000.00	0.00%	0	0.00	0.00%	1,200,000.00	0.00%
M630013	Blerje pajisje kompjuterike	0.00	0.00%	2,100,000.00	0.00%	1,498,000.00	0.00%	0	505,200.00	0.00%	992,800.00	0.00%
M630008	Rikonstruksione	129,712,858.99	93.86%	-	0.00%	-	0.00%	0	0.00	0.00%	-	0.00%
